



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkohet falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Ragip Begaj, Kryetar i komunës

Adresa: Rruga; Skenderbeu p.n. 24000 Malishevë, Malishevë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Malishevës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Malishevës (KMAL), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Malishevës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Malishevës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Malishevës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

A1 Në shtatë(7)* pagesa të testuara në vlerë 245,069€, kemi identifikuar se komuna ka përdorë fondet nga projektet për qëllime tjera nga ajo për të cilin ishin planifikuar, pa i zbatuar proceduat dhe kriteret për transferit dhe rialokimit të ndarjeve buxhetore nga një projekt kapital në një tjetër.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i Çështjes

- 1 Komuna gjatë vitit 2020 kishte paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 352,019€ në kategori ekonomike jo adekuate, si në vijim:
 - Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve ishin paguar 296,682€ për shpenzime të cilat i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve (shujtave për mësimdhënësit sipas kontratës kolektive); dhe
 - Nga kategoria e investimeve kapitale janë paguar 36,000€ për shpenzime të cilat i takojnë kategorisë së subvencioneve dhe 19,337€ ishin për paga përcjellëse dhe shpërblime jubilarë.

Duke qenë se çështja në fjalë është mjaft e përhapur në shumë organizata buxhetore dhe po përsëritet për vite me radhë, ajo do të trajtohet më hollësisht në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të Qeverisë, ku edhe do të jepen rekomandimet përkatëse për zgjidhje afatgjatë.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Malishevës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Malishevës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Malishevës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Malishevës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionin mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Malishevës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlydhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave

financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Pagesa të projekteve nga buxheti i projekteve tjera

Gjetja

Sipas neni 16 pikës 10 të Ligjit mbi ndarjet buxhetore për vitin 2020 nr. 07/I-001, ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese apo zëvendësimin e projekteve kapitale të komunave, të prezantuara në tabelën 4.2. duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal.

Ministri mundet, nëse i ofrohen arsyetime të vlefshme nga ana e kryesuesit të organizatës buxhetore, të autorizojë lëvizjen e mjeteve të alokuara nga një projekt kapital në tjetrin brenda nën-programit të njëjtë të asaj organizate buxhetore. Rialokimet duhet të kryhen në përputhje me procedurat dhe kriteret e parapara me udhëzimin administrativ MF, Nr.05/2019 për procedurat e transferit dhe rialokimit të ndarjeve buxhetore.

Në shtatë (7)* pagesa në vlerë 245,069€, kemi identifikuar se komuna ka përdorë fondet e projekteve për qëllime tjera nga ajo për çka ishin planifikuar, pa i zbatuar procedurat dhe kriteret për transferim dhe rialokimit të ndarjeve buxhetore nga një projekt kapital në një tjetër.

Zyrtarët nuk kanë ofruar ndonjë shpjegim për mos zbatim të kërkesës ligjore.

Ndikimi

Përdorimi i fondeve për qëllime tjera nga ajo për të cilin ishin buxhetuar pa një aprovim paraprak nga kuvendi komunal dhe Ministri i financave përveç që është në kundërshtim me ligjin e buxhetit ndikon që të devijohen projektet e realizuara në raport me ato të planifikuara në kuvendin komunal, në të cilin janë diskutuar dhe aprovuar prioritetet e qytetareve.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të siguroj se janë marrë veprimet e nevojshme që projektet e aprovuara të realizohen sipas planifikimit. Nëse paraqitet nevoja për ridestinim të fondeve të projekteve, kjo të realizohet nëpërmjet justifikimit dhe aprovimit paraprak nga kuvendi komunal bazuar në rregullat përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 8,499,492€, e ku ishin shpenzuar 8,493,329€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 1,297 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 1,316 (Diferenca prej 19 punonjësve nga numri i buxhetuar ka të bëjë me personelin e arsimit që punojnë me gjysëm norme). Kemi testuar 35 mostra për teste substanciale në vlerë 19,516€, si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A2 - Angazhimi për shërbime të veçanta pa kryer procedura ligjore

Gjetja Ligji për zyrtarët publik nr. 06/L-114 në nenin 84 thekson se Marrëveshjet për shërbime të veçanta, lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik. Sipas paragrafit 4 të ndryshim plotësimit të rregullave të KRPP-së për prokurim të shërbimeve të veçanta (konsulent/kontraktorët individual) këto rregulla aplikohen vetëm për prokurimin e shërbimeve të veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit.

Komuna gjatë vitit 2020 kishte angazhuar 23 zyrtarë për shërbime të veçanta këta zyrtarë ishin angazhuar për pozitat si zyrtar në kuvendin komunal, vozitës, zyrtarë në bujqësi, zjarrëfikës, roje pylli. Ne analizuam rastet e angazhimit pas hyrjes në fuqi të ligjit për zyrtarët publik, dhe verifikuam se në (10) dhjetë raste të angazhimeve kontratat ishin nënshkruar pa udhëhequr ndonjë procedurë të prokurimit.

Sipas menaxhmentit kjo ishte rezultat i mungesës së pozitave të aprovuara në planifikimin e buxhetit.

Ndikimi Anashkalimi i procedurave të prokurimit në lidhje me mbulimin e pozitave për shërbime të veçanta, përveç mosrespektimit të procedurave ligjore po ashtu e rrit edhe rrezikun e angazhimit të personave jo adekuat për pozita dhe detyrat e caktuara, çka mund të reflektoj edhe në performancë e tyre në punë.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbushin detyrat e kërkuara. Po ashtu, menaxhmenti duhet të përkujdeset që angazhimet për pozitat e rregullta të zhvillohen përmes procesit të rregullt të rekrutimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,638,338€, prej tyre në 2020 ishin shpenzuar 4,356,410€. Ato kanë të bëjnë kryesisht për ndërtimin e rrugëve, kanalizimit, ndërtim shkollë, etj. Kemi testuar 37 mostra për teste substanciale në vlerë 1,197,874€, si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A3 - Planifikim jo i duhur i procesit të prokurimit

Gjetja

Neni 18.28 i RrUOP-së thekson që kurdo që (Autoriteti Kontraktues) AK nuk dine sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" ose grup të artikujve" në mënyrë që AK të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët në bazë të poentimit, si p.sh. mirëmbajtje të veturave, mirëmbajtje të gjeneratorëve etj. Në dosjen e tenderit "Rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve në komunën e Malishevës" AK ka përcaktuar aplikimin e kontratës kornizë me çmimin për njësi. AK ka bërë peshimin siq kërkohet me rregullat e prokurimit dhe është bërë ndarja e pozicioneve në tri kategori (kategoria A 60%; kategoria B 20% dhe kategoria C 20%). Po ashtu, neni 61.14 të RrUOP, pika b) thekson se Menaxheri i Projektit do t'i raportojë Departamentit të Prokurimit çdo ndryshim në kushtet e kontratës, ose para ose gjatë periudhës së zbatimit, të cilat do të kishin ndikuar në vlerësimin dhe radhitjen e tenderëve dhe në përzgjedhjen e operatorit ekonomik.

Vlerësimi i tenderëve është bërë në përputhje me peshën e përcaktuar dhe me kontratë është shpërblyer OE më i lirë.

Ne analizuam realizimin e kontratës dhe vërejtëm se peshët e ndara për kategori nuk ishin të përcaktuara sipas rëndësisë nga njësia kërkuese pasi që kategoria A "Mirëmbajtja e konstruksionit të rrugës" e peshuar me 60% ishte realizuar me 92% (vlera e realizuar e kategorisë A ishte 110,609€ prej 120,000€ sa ishte vlera totale e kontratës.

Po ashtu menaxheri i projektit gjatë realizimit të kontratës përkundër ndryshimeve thelbësore të kontratës nuk e kishte informuar menaxherin e prokurimit për tejkalimin e theksuar të pozicioneve të kategorisë A. Si pasojë e peshimit jo të drejtë ka rezultuar se realizimi i kontratës të jetë me kosto më të lartë për 26,708€ se njëri nga OE të përgjegjshëm.

Ne nuk kemi pranuar ndonjë sqarim në lidhje me mangësitë në planifikimin dhe realizimin e kësaj kontrate.

Ndikimi

Planifikimi i dobët dhe mos vlerësimi i duhur i nevojave (përfshirë peshimin), ka ndikuar që komuna të lidhë kontratë me çmime për njësi e cila në rastin konkret nuk ishte kontrata më e përshtatshme e rrjedhimisht nuk ishte kontrata më e lirë, duke ndikuar në vlerën për parane e shpenzuar.

Rekomandimi A3 Kryetari, të sigurohet përmes menaxherit të prokurimit se janë duke u aplikuar procedurat adekuate të prokurimit me qëllim të marrjes së vlerës më të mirë për paratë e shpenzuar. Po ashtu, njësitë kërkuese duhet të bëjnë analiza reale të nevojave, përfshirë edhe analizimin e kontratave paraprake gjatë procesit të peshimit që do t'u mundësonte parashikimin e sasive që do të furnizohen.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Zhvillimi i procedurave të prokurimi në mungesë të projektit ekzekutues

Gjetja Sipas pikës 10 të nenit 28 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutiv. Autoriteti Kontraktues (AK) është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutiv, dhe i cili në mënyrë mandatore duhet të bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë AK nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Në dy* raste Komuna ka filluar procedura të prokurimit dhe kishte lidhur kontrata pa hartuar paraprakisht projektin ekzekutiv të ndërtimit.

Kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës së njësive kërkuese pa bërë paraprakisht hartimin e projekteve ekzekutive zbatuese dhe mos funksionimi efikas të kontrolleve tek zyra e prokurimit duke zhvilluar procedurat pa u përmbushur kërkesat ligjore.

Ndikimi Inicimi i procedurës së prokurimit në mungesë të projektit ekzekutues përveq anashkalimit të kërkesave ligjore krijon hapësirë që projektet të cilat iniciohen vetëm me paramasë dhe paralogari të mos jenë të punuara me profesionalizëm të duhur, të ketë vonesa në realizmin e tyre dhe si të tilla mund të kenë kosto shtesë.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit që të gjitha procedurat e prokurimit që kanë të bëjnë me punë të mos iniciohen pa u siguruar se ekziston edhe projekti ekzekutiv. Parapërgatitjet e duhura për një projekt nga njësia kërkuese do të kenë efekt direkt në hartimin e specifikimeve të qarta, duke eliminuar pengesat si të vonesave ashtu edhe të kostove shtesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Specifikimi teknik jo i qartë**Gjetja**

Sipas nenit 28.4 të LPP-së, autoritetet kontraktuese do të formulojnë specifikimet teknike duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës që implementon një standard Evropian, (ii) një standardi Evropian. (iii) një miratimi teknik Evropian, (iv) një specifikimi të përbashkët teknik, (v) një standardi ndërkombëtar apo (vi) çfarëdo referimi tjetër teknik të nxjerrë nga organet Evropiane për standardizim, gjithashtu neni 28.8 “Kërkesat ekzekutuese dhe funksionale duhet të jenë të sakta në mënyrë që të iu mundësoj tenderuesve që të përcaktojnë lëndën kryesore të kontratës dhe t'i lejoj autoritetet kontraktuese që të shpërblejnë kontratën.

Në dy raste gjatë shqyrtimit të specifikave kemi hasur në këto mangësi:

- Te kontrata” Ndërtimi i Qerdhës së fëmijëve në Kijevë” (vlera e kontratës 187,363€), në formulimin e specifikave teknike ishin bërë përshkrime jo të saktë dhe jo të matshëm të pozicioneve si: nuk ka përcaktuar standardin e cilësisë së punimeve apo produkteve të kërkuara, duke kërkuar vetëm Beton; Nuk është përcaktuar trashësia e profilit të dyerve nga PVC; Furnizimi dhe montimi i gypave të butë Pe - Xc/Al 26x3.0mm me vetë izolim - nuk ishte përcaktuar qëndrueshmëria apo rezistenca ndaj temperaturës, Furnizim me pllaka të qeramikës së kualitetit të lart pa dhënë specifika tjera të pllakës për të përcaktuar se si do të matet kualiteti; dhe
- Te kontrata”Zgjerimi i rrugës Malishevë – Banjë”. (vlera e kontratës 365,801€), në formulimin e specifikave teknike komuna për furnizim transporti dhe vendosja e materialit guror të kualitetit të lart, Furnizimi dhe punimi i shtresës së bitoagregatit; Furnizimi transporti dhe montimi i tubave (për puseta) prej betonit të armuar Ø500mm nuk ka përcaktuar standardin e cilësisë së punimeve apo produkteve të kërkuara, sipas të cilit bëhet kontrolli i cilësisë së punëve apo produkteve të kërkuara.

Kjo ka ndodhur për shkak se njësitë kërkuese nuk kanë bërë rishikim adekuat dhe në mënyrë profesionale për të eliminuar paqartësitë dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk ka ushtruar kontrolle të mjaftueshme për të parandaluar këtë mangësi.

Ndikimi

Mos përcaktimi i saktë i standardit të kualitetit të punimeve apo produkteve të kërkuara ndikon që mbikëqyrja e kontratave të mos jetë efikase dhe punimet të kryhen me kualitet të dobët. Kjo bënë që operatorët ekonomik të jenë të keq orientuar dhe mund të ndikoj në ofertën financiare dhe çmimin e kontratës.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurohet që njësitë kërkuese bëjnë hartimin e specifikimeve teknike sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit po ashtu të siguroj se zyra e prokurimit forcon kontrollet e tyre duke mos lejuar që dosja e tenderit të publikohet me pozicione jo të qarta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 108,247,147€, ndërsa vlera e pasurive jokapitale dhe e stoqeve është 139,746€. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 1,908,386€, si dhe 3 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B3 - Evidenca jo të plotë në regjistrat e Pasurisë

Gjetja Sipas nenit 6.3 të rregullores MF – nr. 02/2013 – për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”. Gjatë verifikimit të plotësisë së regjistrat të pasurive, kemi gjetur se:

- Pesë (5)* pasuri kapitale dhe jo kapitale të blera në vitin 2020, me vlerë prej 145,003€, nuk ishin të evidentuara në regjistrin e pasurive; dhe
- Pasuritë nën 1,000€ ishin paraqitur në PFV sipas vlerës fillestare, duke mos aplikuar fare zhvlerësimin, për shkak se ato nuk janë të regjistruara në sistemin e-pasuria. Komuna nuk e aplikon sistemin e-pasuria për regjistrim e pasurisë jo kapitale.

Zyrtarët nuk kanë ofruar ndonjë shpjegim për mos zbatim të kërkesës ligjore.

Ndikimi Mos regjistrimi i të gjitha pasurive, rrit rrezikun që komuna mos të ketë nën kontroll, të gjitha asetet e saj dhe të ketë mangësi në raportim. Po ashtu, mos zhvlerësimi i pasurive jo financiare ka ndikuar që pasuritë nën 1,000€, të mbivlerësohen.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurohet se të gjitha pasuritë regjistrohen në regjistrin e pasurisë në mënyrë që të ulët rrezikun e keqpërdorimit apo humbjes së pasurisë. Po ashtu, sistemi e-pasuria duhet të përdoret për evidentimin e pasurive nën 1000€.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Mangësi në menaxhimin e pasurisë

Gjetja Sipas neni 19.4.3 të rregullores MF– nr.02/2013 – për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore - Komisioni për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare është përgjegjës për krahasimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare dhe identifikimin e pasurisë që nuk ka vlerë të bartur. Po ashtu, sipas nenit 4.1 Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën.

Komuna e kishte kryer inventarizimin e pasurisë pas përgatitjes së PFV-ve (data e inventarizimit 25.05.2021) dhe rrjedhimisht nuk ishte harmonizuar / krahasuar gjendja e inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.

Komuna nuk ka aprovuar rregulla dhe procedurave të brendshme për ndarje të drejt të detyrave për regjistrimin dhe raportimin e pasurive, evidencën dhe ruajtjen e pasurive, ngarkimin e pasurive tek personat përgjegjës që do të kujdeseshin për pasurit e ngarkuara apo edhe procedurën e inventarizimit dhe krahasimit.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme të komunës sa i përket fushës së pasurisë.

Ndikimi

Mungesa e rregullave të brendshme dhe mos krahasimi i raporteve të inventarizimit me regjistrat e pasurisë ka vështirësuar menaxhimin efektiv të pasurisë dhe për rrjedhojë vlera e paraqitur në PFV mund të jetë e pasaktë, pra nuk është prezantuar gjendja reale e pasurisë me të cilat disponon komuna.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të sigurohet se bëhet krahasimi i raporteve të inventarizimit me regjistrat e pasurisë si dhe azhurnohen regjistrat e pasurisë sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit. Kryetari duhet të analizoj nëse është e nevojshme hartimi i procedurave dhe rregulloreve të brendshme për menaxhimin e pasurisë së komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Të arkëtueshmet

Komuna kishte prezantuar në PFV llogari të arkëtueshme në vlerë prej 2,646,699€. Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë 1,648,461€, qiraja komunale 84,263€ taksa komunale 913,975€.

Çështja B5 - Sfidat në menaxhimin e Llogarive të Arkëtueshme

Gjetja

Sipas nenin 26 të ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10€) dhe neni 27 nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e Llogarive të Arkëtueshme (LIA). Ne kemi raportuar edhe vitin e kaluar për mangësi të identifikuar si:

- Komuna për të arkëtueshmet në tatimin në pronë në vlerë 1,648,461€ nuk kishte ndërmarr ndonjë aktivitet për mbledhjen e tyre siç parashihet me ligjin për tatimin në pronë; dhe
- Të arkëtueshmet nga taksat në biznes kishin arritur vlerën 913,976€. Komuna nuk kishte ndërmarr ndonjë veprime konkret për mbledhjen e këtyre borxheve.

Sipas komunës gjendja ekonomike e sociale e qytetarëve të komunës, ka sjell, deri te mos pagesa e borxheve tek tatimi në pronë, derisa sa i përket bizneseve aty ka shumë biznese joaktive.

Ndikimi

Mos arkëtimi i të arkëtueshmeve ndikon që ato të bëhen të pa mbledhshme duke krijuar një rast precedent për borxhlinjtë e tjerë të cilët mund të ndjehen të trajtuar në mënyrë jo të barabartë dhe gjithashtu rezulton me fonde më pak për financimin e projekteve.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të siguroj se mbledhja e llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë bëhet sipas kërkesave ligjore. Ndërsa për llogaritë e arkëtueshme nga taksa në biznes të shqyrtohen të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.5 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2020, ishte 678,767€ . Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2021.

Çështja B6 - Vonesa në pagimin e faturave dhe kostot e procedurave përmbarimore

Gjetja Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për MFPP, Çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendrike pas pranimit të faturës.

Në dy (2) raste faturat në vlerë prej 7,391€ nuk janë paguar në afatin e paraparë ligjor. Vonesat ishin nga 2 deri në 4 muaj.

Po ashtu, Thesari sipas vendimeve gjyqësore/përmbarimore kishte ekzekutuar pagesa nga buxheti i komunës në vlerë prej 829,218€. Prej tyre 603,735€ ishte borxhi kryesor kurse 225,483€ ishin shpenzimet shtesë në emër të procedurës kontestimore /përmbarimore apo interesit

Kjo kishte ndodhur për shkak hyrjes në obligime financiare pa pasur mjete buxhetore të planifikuara dhe mangësive në menaxhimin e obligimeve.

Ndikimi Vonesat në realizimin e pagesave ndikojnë që Komuna të jetë subjekt i padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/ përmbarimore për Komunën.

Rekomandimi B6 Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat dhe detyrimet financiare paguhen brenda afatit ligjor dhe punët apo furnizimet të bëhet vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ^a	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	15,583,801.00	16,324,712.73	15,757,281.20	13,051,959.96	14,140,376.76
Grante Qeveritare – Buxheti	14,687,711.00	15,068,443.14	14,750,075.09	12,144,445.35	13,265,665.12
Financimi përmes huamarrjes	0.00	84,704.00	76,649.71	46,187.20	41,857.39
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	274,335.24	263,417.18	122,518.55	87,914.48
Të hyrat vetanake	896,090.00	896,090.00	667,139.22	738,808.86	666,993.07
Donacionet vendore	0.00	508.06	0.00	0.00	0.00
Donacionet e jashtme	0.00	632.29	0.00	0.00	77,946.70

Buxheti final është më i lartëse buxheti fillestar për 740,912€. Kjo rritje është rezultat i rritjes grantit prej 380,732€ dhe të financimit nga huamarrja prej 84,704€, rritjes nga të hyrave të bartura nga viti paraprak 274,335€, rritjes së donacioneve të brendshme dhe të jashtme me 1.141€.

Në vitin 2020 komuna ka shpenzuar 97% të buxhetit final ose 15.757.281€, me një rritje prej 7% krahasuar me vitin 2019.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	15,583,801.00	16,324,712.73	15,757,281.20	13,051,959.96	14,140,376.76
Pagat dhe mëditjet	8,277,454.00	8,499,492.35	8,493,329.42	8,144,750.98	8,053,285.65
Mallrat dhe shërbimet	1,529,525.00	2,431,882.15	2,182,376.21	1,253,413.33	1,179,387.94
Komunalitë	455,000.00	455,000.00	454,913.50	304,405.11	354,514.02
Subvencionet dhe transferet	220,000.00	300,000.00	270,251.81	104,650.00	65,798.17
Investimet Kapitale	3,840,909.00	4,638,338.23	4,356,410.26	3,244,740.54	4,487,390.98
Rezervat	1,260,913.00	0.00	0.00	0.00	0.00

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillesar ishte rritu për 222.038€, i cili buxhet ishte shpenzuar në tërësi. Kjo rritje ka rezultuar si pasojë e pandemisë Covid 19 nga granti qeveritar prej 149,886€, nga huamarrja prej 72,135€ dhe donacionet 17€;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar është rritur për 902.357€, prej të cilit ishte shpenzuar 90%. Kjo rritje është rezultuar nga granti qeveritar prej 882,052€, nga huamarrja prej 10,147€, të hyrat e bartura 10,000€ dhe donacionet 158€;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 80,000€ i cili ishte shpenzuar në masën prej 90%, kjo rritje ka rezultuar prej grantit të qeverisë; dhe
- Rritja e buxhetit final për investime kapitale prej 797,429€ ishte rezultat i rritjes së grantit për 529,707€, të hyrave të bartura nga viti i kaluar për 264,335€, huamarrja prej 2,422€ dhe nga donacionet 965€.

Komuna për menaxhimin e pandemisë Covid-19 kishte shpenzuar buxhet në vlerë prej 629,125€, prej tyre 244,440€ ishin për shtesat në paga dhe 384,685€ për mallra dhe shërbime.


Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Ndryshimi më i madh i rritjes së shpenzimeve vërehet nga viti 2019 në 2020 ku shpenzimet për investime kapitale janë rritur për 1,111,669€.

Gjithashtu kemi rritje të theksuar të shpenzimeve për mallrat dhe shërbimet krahasuar me vitin paraprak, e që kjo ishte rezultat i përkrahjes së nivelit qendror të komunave për tejkalimin e efekteve negative të pandemis Covid-19.

Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Pjesën më të madhe të shpenzimeve e në strukturën së shpenzimeve të komunës e marrin paga dhe meditje me 54% pasuar nga investimet kapitale me 28% dhe mallrat shërbimet dhe komunalit 14%

Të hyrat e realizuara nga Komuana në 2020 ishin në vlerë 597,329€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Plani i të hyrave ka qenë 896,091€ ndërsa janë realizuar 67% apo 597,329, ku gjithashtu kemi edhe një rënie të të hyrave, por kjo është rezultat i pandemis Covid-19. Përveç të hyrave të prezantuara në tabelë komuna kishte realizuar edhe të hyra indirekte në shumë 222,657€, prej tyre të hyrat nga gjykatat 28,205€ dhe dënimet në trafik 194,452€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	896,091.00	896,091.00	597,328.81	735,244.91	691,457.12
Të hyrat tatimore	444,871.00	444,871.00	271,768.24	293,319.49	268,783.44
Të hyrat jo tatimore	451,220.00	451,220.00	325,560.57	441,925.42	422,673.68

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 ka rezultuar me 14 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Po ashtu, komuna ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve sipas kërkesave të daluara nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, gjashtë rekomandime janë zbatuar, gjashtë nuk janë adresuar dhe dy nuk aplikohen më. Siç është paraqitur në Grafikon 4, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve). (Vëni re se kur ceket fundi i auditimit, i referohemi fundit të procesit të auditimit – deri në momentin kur e dërgojmë raportin e këtij viti).

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që të shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestitim të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Edhe këtë vit komuna nuk kishte planifikuar drejt buxhetin me çka bërë që të ekzekutoj pagesa nga kategoritë jo adekuate. Mirëpo kjo çështje do të trajtohet në RVA	Nuk është i aplikueshëm më.
2.	Të hyrat	Rekomandimi A1 Kryetari duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar që bëhet verifikimi i pronave sipas kërkesës ligjore, në mënyrë që shënimet rreth tatimit në pronë janë të plota dhe të sakta.	Komuna ka realizuar verifikimin e nevojshëm të pronave për tatimin në pronë.	I zbatuar
3.	Pagat dhe mëditjet	Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë se procesi i rekrutimit të personelit të zhvillohet në pajtim me procedurat dhe rregullat e rekrutimit. Po ashtu, komisioni përzgjedhës duhet të dokumentojë si duhet të gjitha fazat e procesit të rekrutimit.	Nga procedurat e testuara nuk kemi hasur në ndonjë parregullsi.	I zbatuar
4.	Pagat dhe mëditjet	Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë se zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit për marrëveshjet për shërbime të veçanta. Po ashtu, të sigurojë se pozitat e rregullta të punës të mos mbulohen me kontrata për detyra specifike dhe marrëveshjeve për shërbime të veçanta.	Edhe këtë vit kemi kontrata për shërbime të veçanta për të cilat ku nuk kishte zhvilluar procedura adekuate, mirëpo nga viti 2020 kemi ndryshim të bazës ligjore dhe rekomandimi është dhënë konformë ligjit të ri tek A3.	Nuk është i aplikueshëm më
5.	Investimet kapitale	Rekomandimi A2 Kryetari të sigurohet se kontrollet funksionojnë në mënyrë efikase gjatë gjithë kohës nga zyra e prokurimit duke mos lejuar që të publikohen dosje të tenderëve pa projekte ekzekutuese.	Nga procedurat e testuara edhe këtë vit kemi hasur që procedura e prokurimit kishin filluar pa plan detal të ndërtimit.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Investimet kapitale	Rekomandimi A3 Kryetari të sigurohet se komisioni për vlerësimin e ofertave të tenderit i trajton të gjitha ofertat në mënyrë të barabartë dhe vlerësimi i ofertave për tender bëhet konform kriterëve të dosjes së ofertës për tender dhe LPP. Gjithashtu zyrtari përgjegjës i	Procedurat e testuar, vlerësimi i ofertave ishte bërë sipas kriterëve të dosjes së tenderit.	I zbatuar

		prokurimit sigurohet se është duke u zbatuar LPP në tërësi duke ushtruar funksionin e kontrolli për parandalim dhe korrigjim të gabimeve.		
7.	Investimet kapitale	Rekomandimi A4 Kryetari të sigurohet që njësitë bëjnë hartimin e specifikimit teknike sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit.	Edhe këtë vit specifikat teknike nuk ishin hartuar sipas LPP.	Nuk ka filluar zbatim
8.	Investimet kapitale	Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë se çertifikimi i pagesave bëhet vetëm pasi lënda të jetë kompletuar me dokumentacionin e nevojshëm, dhe se e njëjta përmban të gjitha dëshmitë e nevojshme të përcaktuara me marrëveshjen e bashkëpunimit.	Nuk kemi hasur në ndonjë parregullsi në çertifikimin e pagesave.	I zbatuar
9.	Investimet kapitale	Rekomandimi A5 Kryetari të sigurohet se blerja e shërbimeve shëndetësore bëhet përmes procedurave të prokurimit.	Komuna për blerje e këtyre shërbimeve e ka bërë me procedurë të prokurimit.	I zbatuar
10.	Pasuritë	Rekomandimi A6 Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha blerjet dhe përvetësimet e pasurive kapitale regjistrohen në regjistrin e pasurive. Gjithashtu të sigurohet se regjistrohen të gjitha pasuritë në sistemin "e-pasuria" dhe fillon të aplikohet norma e zhvlerësimit.	Edhe këtë vit nuk ishin regjistruar të gjitha blerjet në regjistrin e pasurive dhe nuk përdoret s-pasuria për regjistrimin e pasurive nën 1,000 euro.	Nuk ka filluar zbatim
11.	Pasuritë	Rekomandimi A7 Kryetari të sigurohet se janë hartuar rregulla dhe procedura të brendshme për evidencën ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare. Gjithashtu të sigurohet se bëhen krahasimet e raporteve të inventarizimit me regjistrat pasurisë dhe të azhurnohen regjistrat e pasurisë sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit.	Komuna nuk kishte hartuar rregulla dhe procedura dhe nuk kishte bërë krahasimin e regjistrit të pasurive me raportin e inventarizimit siç kërkohet me rregulloren e thesarit për menaxhimin e pasurisë	Nuk ka filluar zbatim
12.	Llogaritë arkëtueshme	Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë se mbledhja e llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë bëhet sipas kërkesave ligjore. Ndërsa për llogaritë e arkëtueshme nga taksat në biznes të shqyrtohen të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve.	Edhe këtë vit komuna nuk ka ndërmarr veprime të nevojshme për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme.	Nuk ka filluar zbatim
13.	Obligimet	Rekomandimi B6 Kryetari të sigurohet që	Edhe këtë vit	Nuk ka filluar zbatim

	papaguara	të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor dhe porositja e mallrave, punëve apo shërbimeve bëhet vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.	komuna nuk i ka paguar detyrimet financiare brenda afatit të përcaktuar kohor.	
14.	Obligimet e papaguara	Rekomandimi A8 Kryetari duhet të sigurojë se detyrimet financiare të prezantohen në pasqyrat financiare sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.	Detyrimet sipas testimi ton janë prezantuar drejt.	I zbatuar

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj se janë marrë veprimet e nevojshme që projektet e aprovuara të realizohen sipas planifikimit. Nëse paraqitet nevoja për ridestitim të fondeve të projekteve, kjo të realizohet nëpërmjet justifikimit dhe aprovimit paraprak nga kuvendi komunal bazuar në rregullat përkatëse.
2.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbushin detyrat e kërkuara. Po ashtu, menaxhmenti duhet të përkujdeset që angazhimet për pozitat e rregullta të zhvillohen përmes procesit të rregullt të rekrutimit.
3.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit që të gjitha procedurat e prokurimit që kanë të bëjnë me punë të mos iniciohen pa u siguruar se ekziston edhe projekti ekzekutiv. Parapërgatitjet e duhura për një projekt nga njësi kërkuese do të kenë efekt direkt në hartimin e specifikimeve të qarta, duke eliminuar pengesat si të vonesave ashtu edhe të kostove shtesë.
4.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurohet që njësitë kërkuese bëjnë hartimin e specifikimeve teknike sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit po ashtu të siguroj se zyra e prokurimit forcon kontrollet e tyre duke mos lejuar që dosja e tenderit të publikohet me pozicione jo të qarta.
5.	Investimet kapitale	Kryetari, të sigurohet përmes menaxherit të prokurimit se janë duke u aplikuar procedurat adekuate të prokurimit me qëllim të marrjes së vlerës më të mirë për parandë e shpenzuar. Po ashtu, njësitë kërkuese duhet të bëjnë analiza reale të nevojave, përfshirë edhe analizimin e kontratave paraprake gjatë procesit të peshimit që do t'u mundësonte parashikimin e sasive që do të furnizohen.
6.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurohet se të gjitha pasuritë regjistrohen në regjistrin e pasurisë në mënyrë që të ulet rreziku i keqpërdorimit apo humbjes së pasurisë. Po ashtu, sistemi e-pasuria duhet të përdoret për evidentimin e pasurive nën 1000€.
7.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurohet se bëhet krahasimi i raporteve të inventarizimit me regjistrat e pasurisë si dhe azhurnohen regjistrat e pasurisë sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit. Kryetari duhet të analizoj nëse është e nevojshme hartimi i procedurave dhe rregulloreve të brendshme për menaxhimin e pasurisë së komunës.
8.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj se mbledhja e llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë bëhet sipas kërkesave ligjore. Ndërsa për llogaritë e arkëtueshme nga taksa në biznes të shqyrtohen të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve.
9.	Obligimet e papaguara	Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat dhe detyrimet financiare paguhen brenda afatit ligjor dhe punët apo furnizimet të bëhet vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Emine Fazliu, Ndhimëse e Auditorit të Përgjithshëm



Faruk Rrahmani, Udhëheqës i Auditimit



Elvir Krasniqi, Udhëheqës i ekipit



Abdurrahmon Bërbatovci, Anëtar i ekipit



Senver Morina, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Malishevës

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE PRANUAR / DORËZUAR: DATUM PRILAZI / DORËZUEN: - 7. 07 2021			
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages	LETËR E KONFIRMIMIT	
04	44	1109	1

07.07.2021

cu/580

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Malishevës, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

pec. z. Kryetari Ragip Begaj

Data: 07.korrik 2021

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁹ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.¹⁰ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënime fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ 1. Komuna për pagesën e datës 15.10.2020 prej 96.417.23€ për ndërtimin e objektit të shkollës fillore në fshatin Panorc ka shfrytëzuar mjetet e ndara me ligjin për buxhet për ndërtimin e shkollave ne Gurbardh dhe Marali. 2. Komuna për pagesën e datës 12.08.2020 prej 14209.12€ për ndërtimin e objektit të shkollës fillore në fshatin Gurbardh ka shfrytëzuar mjetet e ndara me ligjin për buxhet për Bashkëfinancimi me qytetar në projektet e infrastrukturës. 3. Komuna për pagesës e datës 22.12.2020 prej 14026.14€ për ndërtimin e qerdhes në Kijeve ka shfrytëzuar mjetet e ndara me ligjin për buxhet për Ndërtimi i çerdhes ne Malisheve me kod te projektit 49123. 4. Komuna për pagesën e datës 28.10.2020 prej 20000€ Sipas marrëveshjes së bashkëfinancimit për ndërtimin e ujësjellësit në Temeqin Janqisht dhe Senik ka shfrytëzuar mjetet e ndara me ligjin për buxhet për Ujësjellësi në fshatin Astrazup. 5. Komuna për pagesën e datës 11.11.2020 prej 30,216.15€ për Asfaltimin e rrugëve në fshatrat e Malishevës Lot 5, ka shfrytëzuar mjetet e ndara me ligjin për buxhet për Ndërtimi i urës në fshatin Bellanicë, Bubël, Malishevë, Damanek. 6. Komuna për pagesën e datës 04.06.2020 prej 40,633.29€ për Asfaltimin e rrugës në lagjen Miredite në Malishevë ka shfrytëzuar mjetet e ndara me ligjin për buxhet për Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatrat: Turjakë, Janqist, Kërvasari, Drenoc, Pagarushë, Gurishtë, Dragobil, Lumishtë, Mleqan. 7. Komuna për pagesën e datës 18.12.2020 prej 29,567.23€ për Ndërtimin e objektit të veteraneve ka shfrytëzuar mjetet e ndara me ligjin për buxhet për Bashkëfinancimi në projektet e bujqësisë.
- ⁶ NDËRTIMI I ÇERDHËS NË FSHATIN KIJEVË KOMUNA MALISHEVË, 187 362,96 € Ndërtimi i Sistemit të Ujësjellësit në Fshatin Astrazup K-Malishevë, 207 425,30 €.
- ⁷ 1. Harduer kompjuterik, 345€ 2. Ndërtimi i anekseve ne shkolla kontr. NR 79/2018, 40,833 €, 3. Ndërtimi i rrugëve lokale kont NR 43 2019, 60,681€, 4. Ndërtim i rrugëve lokale aneks-kontr NR 41/2019, 18,286€, 5. Pajisje tjera kontr. Nr. 73/2019, 24,858€, Nuk ishin të regjistruara në regjistrin e pasurisë.
- ⁸ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁹ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹⁰ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.